



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 04 maj 2012
Nr. ref.: RK230/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI155/11

Parashtrues

Avni Sahiti dhe anëtarë të tjerë të familjes Sahiti

Kërkesë për vlerësimin e Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Viti nr. 22/2004, të 28 majit 2007, Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Gjilan nr. 323/2007, të 26 tetorit 2007 dhe Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 52/2008, të 10 qershorit 2011

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Avni Sahiti nga Lubishta, Komuna e Vitisë (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), në emër të tij dhe në emër të të afërmve: Binaze Sahitit dhe Mërgim Sahitit. Parashtruesi i kërkesës është xhaxhai i të ndjerës Binaze Sahiti.
2. Parashtruesi i kërkesës beson se atij dhe të gjithë anëtarëve të familjes së tij, gjithsej 27 anëtarë, u është cenuar e drejta për dëmshpërblim si rezultat i vendimeve të gjykatave të ulëta të cilat kishin vendosur që të mos u jepnin kompensim të gjithë anëtarëve të familjes, përfshirë anëtarët e familjes së gjerë, por duke e kufizuar kompensimin vetëm për prindërit dhe vëllezërit e motrat e viktimës.

Baza juridike

3. Kërkesa bazohet në nenet 113 (1) dhe 113 (7) të Kushtetutës, nenet 46, 47, 48 dhe 49 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 56 (2) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja).

Procedura në Gjykatë

4. Më 1 dhjetor 2011, parashtruesi i kërkesës e parashtrroi kërkesën në Gjykatë e cila u regjistrua me nr. KI155/11.
5. Më 17 janar 2012, Kryetari e emëroi gjyqtarin Robert Carolan Gjyqtar raportues si dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Altay Suroy (kryesues), Gjyljeta Mushkolaj dhe Iliriana Islami.
6. Më 19 prill 2012, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i paraqiti Gjykatës rekomandimin për papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

7. Më 10 shtator 2002, Gjykata Komunale në Viti nxori aktgjykimin (nr. P.o. 92/2002) me të cilin e shpalli fajtor A. B. për vepër të rëndë kundër sigurisë së komunikacionit që kishte rezultuar me vdekjen e Binaze Sahitit dhe shkaktimin e lëndimeve të rënda Mërgim Sahitit. A.B. u dënua me 18 muaj burgim.
8. A.B. kishte sigurim të automjetit me kompaninë “Kosova e Re”. Anëtarët e familjes së gjerë dhe të ngushtë të Binaze Sahitit dhe Mërgim Sahitit parashtruan padi për dëmshpërblim nga kompania e sigurimeve për “dhimbje shpirtërore dhe fizike” si rezultat i humbjes së anëtarit të familjes së tyre, Binaze Sahiti, dhe dhimbjes së shkaktuar nga lëndimi i Mërgim Sahitit. Babai i të ndjerës po ashtu i kërkoi shpenzimet e trajtimit mjekësor të shkaktuara nga koha e aksidentit deri më 29 maj 2002 kur Binaze Sahiti vdiq në spital. Shpenzimet tjera të kërkuara përfshinin shpenzimet e varrimit dhe ngritjen e një përmendoreje.
9. Më 27 dhjetor 2003, Gjykata Komunale në Ferizaj konkludoi se nuk ishte kompetente për çështjen e kompensimit dhe vendosi që lënda t'i dërgohej Gjykatës Komunale në Viti.
10. Më 28 maj 2007, me Aktgjykimin nr. 22/2004, Gjykata Komunale në Viti e urdhëroi kompaninë e sigurimeve që t'ua paguante dëmshpërblimin vetëm disa prej paditësve, më saktësisht anëtarëve të familjes së ngushtë. Gjykata Komunale e bazoi vendimin e saj në nenin 154 të LPC duke marrë parasysh deklaratën e padisë, ekspertizën e mjekësisë ligjore dhe përfaqësimet e palëve në gjykatë. Pas vlerësimit të padisë, Gjykata Komunale vendosi që të mos miratojë tërë shumën e kërkuar.
11. Paditësit pastaj parashtruan ankesë në Gjykatën e Qarkut në Gjilan kundër vendimit të Gjykatës Komunale në lidhje me kompensimin që u ishte caktuar. Paditësit pretendonin se Gjykata Komunale gabimisht kishte zbatuar të drejtën materiale, i kishte shkëlur dispozitat procedurale dhe kishte bërë vërtetim jo të plotë të gjendjes faktike.
12. Më 26 tetor 2007, me Aktgjykimin nr. 323/2007, Gjykata e Qarkut në Gjilan e vlerësoi ankesën dhe e hodhi poshtë si pjesërisht të pabazuar. Gjykata e Qarkut e vërtetoi vendimin e Gjykatës Komunale në Viti. Të pakënaqur me rezultatin në Gjykatën e

Qarkut, paditësit parashtruan revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës ndaj vendimit të Gjykatës së Qarkut.

13. Më 10 qershor 2011, me Vendimin nr. 52/2008, Gjykata Supreme e Kosovës e refuzoi revizionin si të pabazuar pasi që shumat që u ishin caktuar paditësve (prindërve dhe vëllezërve e motrave) nga ana e Gjykatës së Qarkut ishin në pajtim me dispozitat materiale dhe procedurale. Rrjedhimisht, u konstatua se Gjykata e Qarkut e kishte zbatuar ligjin në mënyrë të drejtë. Për më tepër, Gjykata Supreme nuk gjeti shkelje të dispozitave procedurale nga Gjykata e Qarkut dhe Gjykata Komunale.
14. Në arsyetimin e saj Gjykata Supreme theksoi si në vijim: “Kjo gjykatë vlerëson se gjykatat e instancës më të ulët në mënyrë të drejtë kanë zbatuar të drejtën materiale edhe në pjesën e kërkesë-padisë të paditësve tjerë kur kanë gjetur se ajo është në tërësi e pabazuar, për arsye se sipas nenit 201 par. 1 të LMD, parashikohet që në rast vdekjeje të ndonjë personi gjykata mund të gjykojë anëtarëve të familjes së tij të ngushtë (bashkëshortit, fëmijës dhe prindërit) kompensim të drejtë në të holla për dhimbjet e tyre shpirtërore, ndërsa me par. 2 të të njëjtit nen parashikohet që ky kompensim mund të gjykohet edhe vëllezërve dhe motrave në qoftë se midis tyre dhe personit të vdekur ka ekzistuar bashkëjetesa e vazhdueshme. Në këtë rast paditësit nuk hyjnë në anëtarët e familjes së ngushtë e të ndjerës dhe nuk janë plotësuar kushtet nga par. 2 të lartpërmendur të njëjtit ligj.”

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

15. Parashtruesi i kërkesës pretendon se familja e gjerë po ashtu ka të drejtë në dëmshpërblim pasi që ata kanë jetuar në “bashkësi familjare” në bazë të “dokeve, zakoneve dhe traditave shqiptare (kosovare)” dhe prandaj kanë të drejtë në dëmshpërblim, jo vetëm prindërit dhe motrat e vëllezërit, pasi që ata janë “familje e madhe” dhe të gjithë kanë përjetuar humbje.
16. Parashtruesi i kërkesës po ashtu pretendon se kompania e sigurimit është dashur t’i përgjigjet kërkesës së tij për të paguar për dërgimin e Binaze Sahitit jashtë vendit për trajtim mjekësor që mund t’ia kishte shpëtuar jetën.
17. Parashtruesi i kërkesës pohon se gjykatat e ulëta i kanë shkelur procedurat gjyqësore që nga fillimi i procedurave në Gjykatën e Qarkut e deri te vendimi i përfundimtar i Gjykatës Supreme. Parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e kanë shkelur Kushtetutën pa specifikuar ndonjë nen konkret të saj.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

18. Për të qenë në gjendje të gjykojë për kërkesën e parashtruesit, Gjykata duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar të gjitha kushtet e pranueshmërisë.
19. Në këtë kuptim, Gjykata i referohet rregullit 36 (1) (a) dhe (c) të Rregullores që përcakton se Gjykata mund t’i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse janë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me ligj dhe nëse kërkesa nuk është qartazi e pabazuar. Rregulli 36 (2) parashikon që Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar nëse bindet se (a) kërkesa nuk arsyetohet *prima facie*; (b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese; (c) parashtruesi nuk është subjekt i ndonjë shkeljeje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë; apo (d) kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.

20. Nga kërkesa është e qartë se parashtruesi i kërkesës kërkon që Gjykata të vlerësojë vendimet e gjykatave të ulëta në lidhje me mjaftueshmërinë e kompensimit që i është caktuar familjes Sahiti si dhe të vlerësojë vendimin për të mos dëmshpërblyer parashtruesin e kërkesës dhe anëtarët e familjes së gjerë.
21. Gjykata duhet të theksojë se nuk është gjykatë e shkallës së katërt dhe si e tillë nuk mund të rigjykojë rastet apo të vlerësojë faktet që kanë çuar gjykatat në marrjen e një vendimi të caktuar.
22. Kjo kërkesë buron nga keqkuptimi i rolit të Gjykatës. Gjykata mund të mos vlerësojë faktet që çuan në marrjen e vendimeve nga ana e gjykatave të ulëta përderisa nuk ka pasur konkluzione flagrante dhe qartazi arbitrare të nxjerra nga gjykatat e që kanë rezultuar në cenimin e të drejtave dhe lirive individuale të mbrojtura me Kushtetutë (*Sisojeva dhe të tjerët kundër Letonisë*, Vendimi i GJEDNJ-së, nr. 60654/00 i 15 janarit 2007).
23. Pas shqyrtimit të procedurave në tërësi, nuk ka prova se vendimet e gjykatave të ulëta kanë qenë në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare (shih *mutatis mutandis*, Shub kundër Lituanisë, Vendimi i GJEDNJ-së në lidhje me pranueshmërinë, nr. 17064/06 të 30 qershorit 2009).
24. Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës nuk i ka argumentuar pretendimet se me vendimet e gjykatave të ulëta atij dhe familjes së tij i janë cenuar të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në përputhje me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe rregullin 36 të Rregullores së punës, njëzëri:

VENDOSI


- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Robert Carolan

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. Dr. Enver Hasani